

... e ka reanuzuar me ndihmën e Forumit Qytetarë (FIQ). Kuvendit Komunal i ka OJQ-së "Koha" që ka ushër sallën me qytetarë nuna përballet me nadhe të qytetareve në re. "Punën që është e njëj Kuvendi e ka bërë të, neve na mungon të debate, kjo na dësh-t të dëgjojmë OJQ-të. prezantuar do të na për ndërtimin e bux-në Gashi. Në pjesën

përfaqësuesi i fshatit Gramnikë, Binak Gashi, pohoi se cilësia e punëve në projektet e kryera në këtë fshat është nën zero dhe se gjithçka që është kryer nuk është bërë si duhet dhe kërkohet edhe mjete tjera për të riparuar. "Ani pse punët janë kryer në rrugë, kanalizim dhe ujësjellës ato nuk janë funksionale, punët janë kryer shkel e shko, tash duhet shpenzohen edhe mjete tjera për të përmirësuar gabimet që janë bërë", tha Gashi i cili propozoi që në komisionin mbikëqyrës të punimeve të përfshihen patjetër banorët. Për mosfunksionim të ujësjellësit në

sipas asaj që kontribuojmë në tatime", është shprehur Veseli. Kurse Dukagjin Gashi nga Dobërdoli tha se nuk është bërë asgjë në këtë fshat disa herë në debatet me pushtetarët i ka paraqitur shqetësimet dhe kërkesat por ato nuk janë marrë për bazë. Edhe qytetarë të tjerë kanë paraqitur problemet me të cilat ballafaqohen ndërkohë që shefi i OJQ-së "Koha" Labinot Krasniqi ka përkujtuar se ekziston edhe një memorandum me komunën për mundësinë që projektet e paraqitura të merren parasysh nga organet komunale.

Skenderaj bëhet me Zyrë për me juridike falas

26 SHKURT - Është përu-ndihmë juridike falas, Agjencisë së pavarur juridike falas, në kuadër ancimi i drejtësisë gjithur nga UNDP-ja, të nderaj.

inë inauguruese drej-tive e Agjencisë, Drita se qytetarët janë të drejtësi andaj atyre mundësia e barabartë rrysh dallimet e mund-këtu edhe ato sociale. ka për synim këtë qel-realizojmë me hapjen komuna të ndryshme deklaruar ajo.

regoi se përcaktimit zyrës në Skenderaj i hulumtimet të cilat e komunat me prob-kanë nevoja më të lloj shërbimesh, për Agjencia është e veria.

yl Ymeri, zëvendës-ësisë, ka treguar se tet e MD është edhe s juridike falas për vës. "Kjo lloj ndihme



në Kosovë përcaktohet si kategori kushtetuese dhe u mundësohet të gjithë atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, duke siguruar kështu që gjendja e rëndë sociale të mos ndikojë në shkeljen e ndonjë të drejtë", tha ai.

Sipas tij, një mundësi e tillë parashihet edhe me Kushtetutën e Kosovës, ndërkaq hapjen e kësaj zyre e quajti si adresë ku nevojtarët që i plotësojnë kriteret kanë mundësi të ri realizojnë pa pagesë të drejtat e tyre.

Steliana Ndera, zv. përfaqësues i përhershëm i UNDP-së në Kosovë, u

ka bërë ftesë qytetarëve që sa më shumë të shfrytëzojnë këto shërbime, derisa Fadil Nura, nënkryetar i Komunës, ka treguar se 2 zyra në objektin e Kryqit të Kuq të Kosovës i janë dhënë agjencisë pa pagesë.

Ndryshe, Kryqi i Kuq i Kosovës në Skenderaj prej pasluftës udhëhiqet nga Ukshin Lushtaku, vëllai i kryetarit të Komunës së Skenderajt. Në ceremoni nuk u lejua të bëhen pyetje nga të pranishmit, me përjashtim të një rasti i cili ishte këmbëngulës për të ditur si është pranuar stafi që punon në këtë zyrë.

Adem Meta

Shoqëria civile kërkon parandalimin e ndotjes së ambientit

LIPJAN, 26 SHKURT - Ndotja e ambientit kohët e fundit në Komunën Lipjanit me rrethinë ka shqetësuar edhe shoqërinë civile në këtë mjedis, teksa Asociacioni Rinor i të Drejtave e Njeriut (YAHR) i ka kërkuar Komunës të ndalojë në pjesë të caktuara djegien pa kontroll të gomave dhe vajrave motorike. "OJQ 'YAHR' shpreh shqetësimin e qytetarëve në Lipjan, lidhur me djegien e gomave dhe vajrave motorike nga gomistët dhe ofiçinat e automjeteve. Djegia e gomave dhe e vajrave nga pronarët e bizneseve për rregullimin e gomave të automjeteve, po shkaktojnë ndotje të ambientit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë po ndikojnë në shëndetin e qytetarëve, në disa pjesë të Lipjanit" ka thënë Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në "YAHR". Sipas tij, edhe pse kjo OJQ vazhdimisht ka apeluar drejt ekzekutivit të Komunës së Lipjanit, më saktë Inspektoratit komunal, për marrje masash nuk është ndërmarrë ndonjë veprim konkret. Krasniqi ka shtuar se me anë të kësaj komunikate, njëherësh tashmë i drejtohet edhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM), Inspektoratit komunal, e Policisë së Kosovës. "Kërkojmë që gjatë sezonit të dimrit në Lipjan që të inspektohen të gjithë gomistët dhe autoserviset, lidhur me djegien e materieve kancerogjene siç janë gomat dhe vajrat motorike dhe njëkohësisht të merren masat ndaj atyre personave të përgjegjshëm", ka thënë Krasniqi. Ndërkohë që, autoritetet komunale të Lipjanit, përkatësisht drejtues të Inspektorisë kanë thënë të kenë marrë masa parandaluese për djegien e gomave në disa fshatra, ndërsa së fundi edhe kanë bërë së paku 2 fletëparaqitje brenda Lipjanit për raste të tilla. Bajram Rizani, drejtor i Inspektorisë komunale, ka deklaruar, të martën, se në çastin që hasen bizneset apo personat e tjerë, duke djegur goma, ata gjobiten prej 100 eurosh. (A.D.)

KKSB-ja e vlerëson të qetë gjendjen e sigurisë në Shtime

SHTIME, 26 SHKURT - Përfaqësues të Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, të shoqërisë civile, drejtorë shkollash dhe përfaqësues institucionesh komunale kanë diskutuar të martën, për sigurinë në bashkësi. Në këtë takim pjesëmarrësit e kanë vlerësuar të qetë gjendjen e sigurisë, megjithëse kanë potencuar disa çështje që në mënyrë indirekte rrezikojnë qytetarët, siç janë: siguria në komunikacion, mungesa e aparateve të zjarrit në shkolla dhe institucione të tjera, vetëdijësimin e të rinjve për dukuritë negative, rrjeti elektrik i vjetruar, qentë endacakë etj. Rrahman Jakupi, zëdhënës i Komunës së Shtimes, ka thënë se Komuna e Shtimes, Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi në bashkëpunim me OJQ-të, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Saferworld kanë implementuar planin për diskutime konsultuese me qytetarë për sigurinë në bashkësi ku në kuadër të këtij plani është paraparë që të mbahet edhe një diskutim publik. "Nga këto konsultime KKSB-ja do të hartojë edhe planin e veprimit për 2013 dhe projektet me prioritet për sigurinë në bashkësi në Shtime", ka thënë Jakupi. (A.A.)